

Edhe të rriturit mund të mësojnë një profesion të ri! **Qyteti i Cyrihut ju ndihmon. Edhe juve!**

Kaloni nga ne.
Konsulta e parë është **falas!**

Dëshironi të mësoni një profesion të ri?

- Keni pagë të ulët dhe prandaj duhet të punoni shumë?
- A është problem orari juaj i punës?
- Jeni i pakënaqur në punën tuaj dhe dëshironi të dini se si mund të ndryshoni diçka?

Mund të merrni ndihmë në Qendrën e Karrierës. Ndoshta një kualifikim i mëtejshëm
është mirë për ju. Ose mund të bëni një
trajnim. Për këtë qyteti i Cyrihut mund t'ju japë para.

Laubahnzentrum (Qendra e Karrierës)

Adresa: Konradstrasse 58, 8005 Zürich
Telefoni: +41 44 412 78 80
Emaili: laufbahnhzentrum@zuerich.ch



Çfarë është një kualifikim i mëtejshëm?

Një kualifikim i mëtejshëm është një kurs për një temë të caktuar. Kjo mund të jetë, për shembull, një kurs gjuhe ose një kurs kompjuteri. Me një kualifikim të mëtejshëm ju mund të bëni më shumë në profesionin tuaj. Ndoshta mund të merrni edhe një rrogë më të lartë. Ose mund të gjeni një vend të ri pune që është më i mirë për ju.

Çfarë është Qendra e Karrierës?

Qendra e Karrierës trajton profesione, trajnime dhe kualifikime të mëtejshme. Specialistët mund t'ju këshillojnë. Ju mund të merrni informacione dhe specialistët mund t'ju ndihmojnë nëse keni nevojë për para për një trajnim.

Çfarë ndodh në Qendrën e Karrierës?

- Ju flisni me një specialist rreth profesionit tuaj dhe rreth atyre që keni mësuar.
- Specialisti do të dijë shumë gjëra rreth jush. Për shembull, se çfarë mund të bëni tjetër ose sa mirë e flisni gjermanishten.
- Specialisti shikon me ju se cili profesion ose cili kualifikim i mëtejshëm është i mirë për ju.
- Specialisti ju ndihmon në mënyrë që të merrni para për një kualifikim të mëtejshëm.

Kush mund të marrë para për një kualifikim të mëtejshëm?

Të gjithë personat që

- banojnë që prej më shumë se 2 vitesh në qytetin e Cyrihut dhe
- kanë një punë që prej 5 vitesh, por marrin pak para.

Laubahnzentrum (Qendra e Karrierës)

Adresa: Konradstrasse 58, 8005 Zürich

Telefoni: +41 44 412 78 80

Emaili: laufbahnhzentrum@zuerich.ch

